

“Të dashur bashkëqytetarë të Bashkisë Shkodër. Zgjedhjet e 14 Majit janë një moment i rëndësishëm për të gjithë ne, e mbi të gjitha për rrugën që duam të ndjekim për këtë 4-vjeçar në zhvillimin e bashkisë tonë. Kam kënaqësinë t’ju njoh me programin tonë për drejtimin e Shkodrës në këto 4 vite, i cili vjen i projektuar në detaje për t’i dhënë zhvillimin e duhur territorit me të gjitha potencialet që ka. Ekspertët më të mirë kanë punuar për ndërtimin e tij, duke e orientuar Bashkinë Shkodër drejt zhvillimit të qëndrueshëm, rritjes ekonomike, hapjes dhe bashkëpunimit në të gjitha nivelet me institucionet kombëtare, partnerët ndërkombëtare dhe investitorë strategjik. Programi ynë 2023-2027 projektton një bashki që ndryshon me hapa të shpejtë dhe që kthehet lider në rajon.”



PROGRAMI POLITIK

ORIENTIMI STRATEGJIK

OBJEKTIVAT OPERACIONAL

SHKODRA ME ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

SHKODRA TURISTIKE

SHKODRA INOVATIVE

SHKODRA ME SHËRBIME CILËSORE

Shkodra kryeqendër ekonomike rajonale

Inovacioni dhe teknologjia

Turizëm në 12 muaj

Zhvillimi rural

Shkodra me shumë qendra (Policentrike)

Shërbimet publike për komunitetin

Eko mobiliteti

Shkodra e gjelbër

Djep i kulturës, artit dhe trashëgimisë

Shkodra e sportit

Shkolla cilësore në shërbim të komunitetit dhe bashkëpunimi me universitetin

Shkodra e rinisë

Familja dhe mirëqënia sociale

Marrëdhëniet rajonale e ndërkombëtare të Shkodrës

Bashki transparente dhe pranë qytetarit


Mbrojtja Civile

- Rrjeti i Tregtisë
- Zona Industriale dhe Zhvillimi Ekonomik
- Zhvillimi i Akseve Tregtare
- Zhvillimi i zonave me karakter tregtar
- Mbështetja e bizneseve të vogla e të mesme
- Nxitja dhe përkrahja e nismave me karakter formues profesional në fushën e teknologjisë dhe informacionit
- Krijimi i hapësirave Co-working për Nomadët Digital dhe sipërmarrës të rinj në fushën e teknologjisë
- Rritja e aksesit në resurset turistike
- Zhvillimi i produktit Turistik Promocioni turistik
- Shkodra qyteti i mikpritjes dhe kulturës
- Bujqësia dhe Blegtoria
- Shërbimet Bujqësore
- Zhvillimi i Agroturizmit
- Promovimi i Produktit Lokal
- Plani operativ i Rikualifikimit Urban
- Rregullimi i Portave Hyrëse të Qytetit
- Qëndrat e gravitetit të Fshatrave Arredimi Urban
- Urbanizimi i zonave Informale
- Zonat Pedonale
- Rikualifikimet e Bulevardeve
- Mirëmbajtja e rrugëve, trotuareve dhe sinjalistika
- Ndricimi SMART
- Rrjeti Ujshjellës Kanalizime
- Policia Bashkiake dhe komuniteti
- Monitorimi Inteligent i Qytetit
- Terminalet Multimodale
- Rrjeti i Bicikletave
- Transporti Publik
- Rikualifikimi i Parkut të Bexhënit
- Kurora e Gjelbërt e Qytetit
- Shtimi, mirëmbajtja dhe nxitja e frekuentimit të hapësirave të gjelbërta
- Menaxhimi i Mbetjeve Urbane
- Infrastruktura e objekteve kulturore
- Shkodra, një muze i hapur
- Kultura Digitale
- Shkodra Qyteti i Memories dhe traditës qytetare
- Shkodra Qytet Sportiv
- Mbështetja e Disiplinave Sportive
- Sporti në çdo Rajon e Njësi Administrative
- Jeto me Sportin
- Infrastruktura në shkolla
- Shkolla e Hapur për komunitetin 24/7
- Krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e mësimi
- Kopshtet dhe Çerdhet
- Marrëdhëniet me Universitetin
- Qendra Rinore Atelle 'Hub' i zhvillimit të rinisë Shkodrane
- Aftësimi profesional dhe kreativ
- Banesat Sociale dhe strehimi
- Edukimi Qytetar
- Shkodra e Aksesueshme
- Institucionet rezidenciale
- Mirëqënia Sociale
- Shërbimi shëndetësor
- Shkodra dhe Partnerët e Huaj
- E-Qeverisja
- Administrimi i Lagjeve dhe Njësi Administrative
- Marrëdhëniet me Institucionet
- Parandalimi i Përmytjeve
- Shërbimet e Emergjencave Civile

PËRMIRËSIM I CILËSISË SË JETESËS SË BANORËVE




ORIENTIMI STRATEGJIK SHKODRA KRYEQENDËR EKONOMIKE RAJONALE



Shkodra si kryeqendër e rajonit përveç lidhjeve strategjike infrastrukturore do të ketë edhe sektorë ekonomie, të cilët janë konkurrente në tregjet lokale dhe rajonale. Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik janë të lidhura ngushtësisht me territorin dhe potencialin që ka Shkodra. Boshtet kryesore ku do të bazohet zhvillimi ekonomik do të jenë të lidhura me zhvillimin e industrisë së lehtë dhe mbështetjen për zonat ekonomike, zhvillimin e rrjetit të tregtisë, zhvillimit të turizmit si sektori me potenciale të jashtëzakonshme për Shkodrën si dhe zhvillimi rural. Të gjithë këto sektor do të mbështeten nga Bashkia Shkodër përmes një qasjeje inovative ku kujdes të vecantë do të ketë integrimi i brezave të rinj në ekonomi duke sjellë inovacion dhe zhvillim të bizneseve të reja. Përkthimi i avantazheve konkurruese në mundësi për investime të huaja, të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe social, do të bëjë të mundur që cdo territor me karakteristikat që përfaqëson të kontribuojë në mirëqenien e banorëve tanë. Politikat e zhvillimit të Bashkisë Shkodër do të jenë të fokusuar në mbështetjen e sipërmarrjeve të vogla e të mesme që ndikojnë direkt në punësim dhe në ekonominë e bashkisë. Bizneset private do të kenë një barrë fiskale minimale nga ana e Bashkisë dhe shërbime të dedikuara për të mundësuar zhvillimin e tyre.

SHKODRA KRYEQENDËR EKONOMIKE

Bashkia Shkodër ka të identifikuar nevojën për një rrjet tregtie, i cili do të nxisë tregtimin e produktit lokal në të gjithë territorin. Duke filluar nga zona e Dukagjinit, Postriba, Guri i Zi, Rrethinat, Ana e Malit, Bërdica, Dajçi e Velipoja, Shkodra ka një potencial të madh dhe të diversifikuar bujqësor me produktet lokale specifike të cilat kërkojnë praninë e tregjeve për të nxitur tregtimin dhe zhvilluar ekonomite rurale. Duke vlerësuar edhe sipërfaqen e madhe të tokave bujqësore dhe angazhimin e lartë të banorëve të zonave rurale në fushën e bujqësisë bashkia Shkodër ka identifikuar nevojën për 4 tregje rajonale të produkteve bujqësore: Tregu i produkteve lokale Shkodër, Tregu rajonal Bërdicë, Tregu rajonal Mes (Postribë), Tregu rajonal Velipojë. Ndërhyrje cilësore do të realizohet në “Merkatën e Rusit” si dhe tregjet ditore të rajoneve/lagjeve në përmirësim të kushteve të tregtimit.



Shkodra është kryeqendër ekonomike si rezultat i lidhjes strategjike që ka me qendrën e Shqipërisë dhe Podgoricën duke ofruar një gamë të gjërë produktesh të industrisë së lehtë për tregjet e brendshme dhe të jashtme. Zona Industriale Shkodër përfaqëson qendrën e zhvillimit ekonomik të Shkodrës me një numër të lartë sipërmarrjesh prodhuese të cilat krijojnë ekonomi dhe punësim. Bashkia Shkodër do të ndikojë në rigjenerimin dhe vënie në funksion të bizneseve të ndërtesave të papërdorura duke e lehtësuar tërheqjen e investimeve të huaja që duan të zhvillojnë sipërmarrjet e tyre në Shkodër.

Rijetëzimi i ndërtesave të vjetra së bashku me përmirësimin e shërbimeve publike dhe promovimin e kësaj zone si një “Hub Ekonomik” do të nxisë rritjen ekonomike. Bashkia Shkodër do të asistojë çdo investitor të interesuar duke krijuar lehtësira për ta bërë sa më tërheqë investimin në Shkodër. Një vëmendje e veçantë do ti jepet shërbimeve publike për punonjësit përmes përmirësimit të transportit dhe krijimit të kopshteve dhe çerdheve në afërsi të kësaj zone.




Zhvillimi i
Akseve
Tregtare

Akset lidhëse të qytetit janë transformuar vit pas viti në akse të rëndësishme tregtare dhe prodhuese si rezultat i lëvizshmërisë së lartë në këto rrugë, duke u valorizuar edhe si akse ekonomike. Në këtë kontekst rruga Shkodër – Koplik dhe Ura e Bahçallekut – Bërdicë shihen si dy akse të rëndësishme ekonomike në të cilat do të fokusohet vëmendja e Bashkisë sa i përket rikualifikimeve urbane por edhe shtimit të shërbimeve në zonë që nxisin zhvillimin e bizneseve. Krijimi i mundësive për përdorim të rrugëve dytësore të aksesit për bizneset e shumta të këtyre akseve do të lehtësojë lëvizshmërinë dhe përmirësojë trafikun hyrës dhe dalës në qytet. Zhvillimi urban i këtyre dy zonave do të ndikojë në krijimin e zonave ekonomike dhe përfortimit të identitetit “Shkodra Kryeqendër Ekonomike”



Zhvillimi i zonave me karakter tregtar

Rivitalizimi urban i zonave me karakter tregtar do të ndikojë në përmirësimin urban dhe zhvillimin ekonomik të zonës. Rruga Hamz Kazazi dhe Elvija Çelebiu (Lagjja Zdrale) së bashku përfaqësojnë vijimësinë e tregtisë dhe bizneseve të vogla të qytetit të Shkodrës. Unifikimi i fasadave, përmirësimi i infrastrukturës dhe promovimi i identitetit tregtar të zonës dhe të qytetit në tërësi do të ketë impakt pozitiv për imazhin fizik por edhe zhvillimin ekonomik. Shit-blerja në tregun “Zdrale” nga një aktivitet rutinë i banorëve dhe vizitorëve do të kthehet në një përjetim dhe atraksion për vizitorët, banorët dhe tregtarët. Gjithashtu projekti do të ndikojë në rritjen e vlerës së pronës për këtë zonë duke tërhequr investime private të cilat zhvillojnë edhe urbanistikën e zonës.




Mbështetja e bizneseve të vogla e të mesme

Me një ekonomi vitale e cila përfaqësohet nga një numër prej rreth 5600 bizneseve të vogla e të mesme Shkodra është nga qytetet që zhvillimin ekonomik e ka të lidhur me punën në sektorët e ndryshëm të ekonomisë duke filluar nga aktivitetet tregtare tek ato të prodhimit apo shërbimeve. Bashkia Shkodër do të ketë në fokus krijimin e klimës së mirë të biznesit duke mbajtur një barrë fiskale të ulët dhe nxitur hapjen e bizneseve të reja. Nga ana insitucionale bizneset në Bashkinë Shkodër do të gjejnë një portë të hapur me shërbime lehtësuese për praktikat burokratike. Inovacioni është një pikë e fortë ku do të fokusohemi përmes krijimit të inkubatorëve të biznesit që do të ndikojnë në gjenerimin e ideve të reja për biznes. Gjithashtu rritja dhe zhvillimi i forcës së punës të kualifikuar do të jetë një tjetër synim dhe angazhim i joni për të pasur një fuqi punëtore konkurruese në shërbim të bizneseve të vogla e të mesme. Organizimi dhe mbështetja e panairëve që promovojnë bizneset tona të fushave të ndryshme do të ketë ndikim në marketimin e produkteve të territorit, nga ato të industrisë tekstile, tek produktet rurale dhe artizanale apo produktin turistik, në të gjithë rajonin.





ORIENTIMI STRATEGJIK INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA



Nxitja dhe përkrahja e nismave me karakter formues profesional në fushën e teknologjisë dhe informacionit


Bashkia Shkodër është një nga qytetet më numrin më të madh të të rinjve në raport me popullsinë, kjo si rezultat i pranisë së shkollave publike dhe private si dhe universitetit me degë të ndryshme, që krijojnë mundësi të mira për arsimim dhe edukim. Të rinjtë në Shkodër si çdo të rinj në të gjithë Europën tashmë kanë një qasje më inovative dhe kreative ndaj të ardhmes, duke u fokusuar në edukimin dhe arsimimin me degë të reja apo kapacitete inovatore. Teknologjitë e reja dhe mundësia për të pasur një punësim duke shfrytëzuar risitë teknologjike kanë bërë që të kemi një numër të madh të rinjsh që studiojnë në degët e informatikës apo teknologjisë së informacionit duke ndryshuar nga koncepti i ngurtë i shkollimit në degët klasike të ekonomikut, juridikut etj. Bashkia Shkodër duke vlerësuar këtë tendencë ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me shkollat dhe universitetin për të krijuar mundësi të reja dhe hapsira sa më të mira për të rinjtë. Përmes qendrës rinore Atelie, administruar nga Bashkia Shkodër ne i kemi dhënë prioritet iniciativave që realizohen nga partnerët tanë për kurse dhe trajnime të ndryshme në fushat që janë tashmë risi në të gjithë europën, duke filluar nga kurset e robotikës, kreativitetit, IT etj.

e.DO LEARNING CENTER
in short

WHAT IS e.DO™ LEARNING CENTER?
An engaging educational environment to discover the inspiring potential of Robotics while learning.

WHO ARE THE BENEFICIARIES?
Students from 8 to 19 years old who want to give a closer look on the scientific world.

HOW DOES IT WORK?
• 5 e.DO installed
• 4-hour Training Packages (Mathematics, Technical Education, Coding)
• Hundreds of Activity Cards
• Certified facilitator



Krijimi i hapësirave Co-working për Nomad Digital dhe sipërmarrës të rinj në fushën e teknologjisë

Bashkia Shkodër do të luajë një rol të rëndësishëm në promovimin e kapitalit njerëzor dhe mundësive për të investuar në Shkodër, sa i përket bizneseve që punësojnë të rinjtë. Duke parë numrin e madh të largimit të të rinjve nga territori, ndër orientimet kryesore, do të jetë ai i tërheqjes së investimeve të huaja, të cilat tek Bashkia Shkodër do të gjejnë një urë lidhëse me territorin dhe kapitalin njerëzor. Krijimi i kushteve për zhvillim të këtyre investimeve do të krijojë mundësinë e punësimit për të rinjtë tanë duke i siguruar atyre një të ardhme të sigurtë në Shkodër. Bizneset e interesuara për të zhvilluar investime në fushën e teknologjisë së inovacionit, për të përfshirë kështu në tregun e punës të rinjtë e Shkodrës, të cilët do të asistohen në çdo hap për trajnimet dhe formimet profesionale nga ana e Bashkisë. Shkodra do të ketë hapsira të dedikuara për Co-Working duke u bërë një zonë që tërheq “Nomadët Digjital” përmes krijimit të kushteve për zhvillimin e këtij sektori inovativ. Në hapësirat publike dhe ato me flukse të mëdha vizitorësh do të instalohet Wi-Fi falas duke e orientuar qytetin në një SMART City.



e.DO Learning Center is an innovative education environment where primary and secondary school students can use robots to enhance their knowledge on various school subjects.

The young attendees, from 8 to 19 years old, discover and experience e.DO in an engaging session focusing on STEM, Soft Skills and Industrial Culture, which form a basis for their future growth.

e.DO Learning Center is equipped with ready-to-use material, specifically designed to support the delivery of the Training Packages by a certified facilitator.


- e.DO + Gigger
- Motor-Header
- Working Board
- Packages Box
- Robot (optional)

- Installation and assistance
- Training and certification of facilitators





ORIENTIMI STRATEGJIK TURIZËM NË 12 MUAJ



Rëndësi e veçantë i është dedikuar Turizmit, si një nga resurset kryesore ekonomike të zhvillimit të një prej qyteteve më të veçanta në rajon, duke u përqëndruar në dy drejtime:

- Zhvillimi i infrastrukturës në shërbim të turizmit
- Zhvillimi i produktit turistik dhe shërbimit ndaj turistëve

Një sërë rikualifikimesh ndërhyrjesh në të gjithë infrastrukturën e territorit duke filluar nga lulishtet në Velipojë apo qytet, rikonceptimi i pedonaleve së Shkodrës, rruga Shirokë - Zogaj, lulishtja e Bexhistenit, rruga Theth - Ndërlisë, qendra e Thethit, aksi rrugor i mbylljes së unazës së Alpeve, (Rruga e Dukagjinit), Kalaja e Drishtit, zbatimi i komponenteve të Programit të investimeve Rituus, Rikualifikimi dhe hapja e shtigjeve të reja turistike do të jenë investime me ndikim në zhvillimin e sektorit turistik duke ndikuar edhe në përmirësimin e jetës së banorëve. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm mund të nxisë zhvillimin e infrastrukturës duke filluar nga përmirësimi i rrugëve dhe aksesit tek transporti apo lehtësia e komunikimit. Nga këto ndërhyrje do të përfitojnë vizitorët/turistët por edhe komuniteti vendas duke patur rritje në cilësinë e jetesës.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar një sërë aktiviteteve të mëdha promovionale dhe rekreative, të cilat kanë valorizuar vlerat e zonës së Shkodrës, duke bërë që Shkodra të ketë një rritje prej 30% të numrit të vizitorëve e turistëve.

Turizmi është ndër sektorët kryesor ku do të fokusohet programi i zhvillimit të Bashkisë sonë duke ndikuar direkt në:

Zhvillimin ekonomik – përfitime të konsiderueshme ekonomike përmes krijimit të vendeve të punës si dhe zhvilluar bizneset lokale për të gjeneruar më shumë të ardhura.

Promovimi i Bashkisë – do të ndihmojë në rritjen dhe përmirësimin e imazhit të Bashkisë duke ndikuar në rritjen e interesit të vizitorëve.

Ruajtja e mjedisit – turizmi i qëndrueshëm do të zhvillohet duke inkurajuar praktikatat e mira të turizmit të përgjegjshëm, ekoturizmit dhe turizmit të bazuar në komunitet. Kjo do të ndikojë në mbrojtjen e burimeve natyrore, ekosistemeve dhe trashëgimisë kulturore.

Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore unike duke shfaqur traditat, kuzhinën, muzikën dhe artet lokale do të ndikojë në zhvillimin e sektorit të turizmit.


Tërheqja e investimeve të huaja dhe bashkëpunimi me aktorët e sektorit, bizneset dhe komunitetin është një tjetër objektivi që do të zbatohet nga Bashkia për të krijuar një klimë sa më të favorshme për zhvillimin e këtij sektori.



Rritja e aksesit në resurset turistike

Zhvillimi i infrastrukturës në shërbim të turizmit do të jetë një nga prioritetet e punës së Bashkisë. Një sërë projektesh infrastrukturorë janë në zbatim dhe të tjera janë të identifikuar. Shkodra është e pasur me atraksione turistike duke filluar nga zona e Alpeve, Qyteti, Liqeni apo bregdeti Adriatik. Investimet do të shtrihen duke filluar nga Qendra e Thethit përmes rikualifikimit të qendrës dhe arredimit urban të saj për të rritur atraksionin e kësaj zone. Me synim zhvillimin e sektorit të turizmit në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë janë identifikuar një sërë ndërhyrjesh edhe në atraksione më pak të njohura të cilat do të përmirësojnë infrastrukturën duke rritur numrin e vizitorëve dhe për rrjedhojë zhvillimin ekonomik. Ndërtimi i rrugës së Dukagjinit është prioriteti i jonë dhe do të jemi të angazhuar për fillimin e zbatimit të këtij projekti me qeverinë apo çdo donator të mundshëm për të hapur rrugën e zhvillimit të kësaj zone me kaq vlera për ne. Rikualifikimi i Kalasë së Drishtit dhe Urës së Mesit janë ndërhyrje ku e gjithë zona e Postribës do të ketë një infrastrukturë të re me fasada dhe qëndër fshati të rikualifikuar duke valorizuar edhe Urën e Mesit si pasuri historike e territorit. Liqeni i Shkodrës si një nga asetet më të veçanta turistike do të jetë qendra e zhvillimit të turizmit natyror. Rikualifikimi i brigjeve të liqenit, ndërtimi i rrugës Shirokë Zogaj dhe moleve të liqenit, shtigjet e reja në Tarabosh, ndërtimi i muzeut të liqenit do të ndikojnë në valorizimin e mëtejshëm të zonës. Vëmendje të shtuar do të ketë bregdeti ku numri i lartë i turistëve e bën të nevojshme rritjen e investimeve dhe shërbimeve në zonë. Kështu përfundimi i asfaltimit të rrugëve të brendshme, gjelbërimi dhe sheshet publike, ndriçimi publik i Velipojës do të jenë investimet e vazhdueshme për të zhvilluar më tej një nga zonat më të frekuentuara të Shkodrës. Zbatimi i projekteve ambicioze RITUUS (për zonën e Velipojës dhe Rrjollit) me financimin e BE-së do të transformojë dhe ofrojë shërbime të shtuara për zhvillimin e bregdetit tonë, me një orientim afatgjatë. Rikualifikimi i Kalasë dhe Kuartieri i Muzeve janë të tjera projekte ambicioze që do të realizohen me bashkëpunimin e donatorëve.

ORIENTIMI 3



Baks Rjoll





Zhvillimi i produktit turistik

Diversifikimi i produkteve turistike për zhvillimin e turizmit gjithëvjetor do të ketë në qendër të vëmendjes bashkëpunimin me sipërmarrësit dhe komunitetet vendase për të zhvilluar produkte të reja turistike që i përgjigjen tregjeve dhe preferencave të ndryshme. Ne do të inkurajojmë zhvillimin e produkteve ekzistuese, të tilla si turizmi balnear, eko-turizmi, turizmi i aventurës, turizmi kulturor dhe turizmi gastronomik, dhe do të ofrojmë mbështetje për zhvillimin e produkteve të reja turistike, duke përfshirë financimin, trajnimin dhe marketingun. Zhvillimi i Ekoturizmit – Agroturizmit – Turizmit Malor, Detit, Rërës, Diellit dhe turizmi liqenor të ndërthurur me atraksionin e qytetit dhe aktiviteteve të mëdha do të ndikojnë në shtrirjen e vizitueshmërisë së Shkodrës përgjatë gjithë vitit. Promovimi i paketave turistike të cilat targetojnë turistë specifik, sipas veçorive që ofron eksperiencë turistike në Shkodër, do të jetë një punë e vazhdueshme dhe e përbashkët me operatorët e sektorit.



Zhvillimi i një plani marketingu që synon tregje dhe segmente specifike të turizmit duke ndërthurur komunikimin online dhe offline përmes mediave sociale, faqeve të internetit, broshurave guidave turistike është një tjetër element në favor të zhvillimit të turizmit. Teknologjia e informacionit është një nga instrumentet që do të përdoret për promovimin turistik duke paraqitur në treg zgjidhje dixhitale që përmirësojnë përvojën turistike të tilla si aplikacione për Smartphone, platforma online, për rezervimin e shërbimeve turistike dhe promovim të territorit në mediat sociale. Pikat e informacionit turistik do të jenë të përqëndruara në zonat e atraksionit duke filluar nga qendra e qytetit, Shiroka, Velipoja, Thethi, dhe do të jenë të paisura me materialet e duhura promovionale dhe ndihmëse për turistët. Me shumë rëndësi për rritjen e atraksionit turistik mbetet rritja e shërbimeve turistike si: Promovimi i territorit të Bashkisë nëpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promovionale dhe informuese. Organizimit dhe pjesëmarrjes në panairë lokale, kombëtare dhe ndërkombetare. Organizimit të aktiviteteve për promovimin e ofertave e produkteve turistike të Bashkisë Shkodër.




Ngritjes së kapaciteteve të bizneseve që operojnë në fushën e turizmit me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit nga ana e tyre do t'i jepet një vëmendje e veçantë. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve turistike përmes ofrimit të trajnimeve dhe mbështetjes për bizneset lokale, duke përfshirë hotelet, restorantet, operatorët turistikë dhe guidat, për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe produkteve të tyre është me shumë rëndësi për të patur një turizëm të qëndrueshëm që transmeton eksperiencë të paharruar për vizitorët. Ne gjithashtu do të inkurajojmë bizneset të adoptojnë praktika të qëndrueshme, të tilla si paketimi i riciklueshëm, efikasiteti i energjisë dhe reduktimi i mbetjeve për të zhvilluar një produkt turistik të qëndrueshëm në terma afatgjatë dhe në harmoni me mjedisin.







ORIENTIMI STRATEGJIK ZHVILLIMI RURAL



Duke u përqëndruar në një nga objektivat kryesorë të këtij programi, atij të zhvillimit ekonomik, zhvillimi i sektorit të bujqësisë do të ketë vëmendjen e të gjitha strukturave të dedikuara. Rritja e konkurrueshmërisë dhe promovimi i produkteve lokale, mbështetja e fermave për të rritur të ardhurat e tyre, konsolidimi i aftësive përpunuese të produkteve, asistenca në sigurimin e kontratave të reja për tregtimin e produktit do të jenë disa nga orientimet bazë ku do të punojmë për të krijuar mundësitë e zhvillimit të fermave të territorit tonë. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë është i lidhur direkt me produktin e territorit duke ndihmuar edhe në zhvillimin e tregtisë, agroturizmeve, gastronomisë dhe kryesisht shëndetit për konsumatorët. Mbështetja për këtë sektor të ekonomisë është me shumë vlera për territorin e Shkodrës duke marrë parasysh bonitetin e lartë të tokave bujqësore dhe potencialit që ka ky sektor për zhvillimin ekonomik dhe punësimin e të rinjve. Njësitë administrative me karakter bujqësor e blegtoral do të kenë nyjet bujqësore ku do të krijohen qendrat e grumbullimit dhe tregtimit të produkteve. Siguria e produkteve, çertifikimi, ambalazhimi dhe mbështetja për tregtim është baza për një ekonomi të zhvilluar rurale. Këshillimi dhe orientimi i fermerëve për të aplikuar për grantet e zhvillimit të këtij sektori do të jetë detyrë specifike e bashkisë Shkodër për të rritur kapacitetet e fermave tona.



Bashkia Shkodër, pas reformës territoriale, ka trashëguar një rrjet kanalesh ujitëse dhe kulluese në të cilat po vijon puna për rritjen e performacës së tyre në shërbim të fermerëve dhe zhvillimit të sektorit bujqësor. Pastrimi i kanaleve kulluese ka rol direkt në prodhimin bujqësor dhe gjithashtu sa i përket reduktimit të pasojave të përmbytjeve, prandaj është një proces që do të përfshijë të gjithë territorin duke rritur sipërfaqen e tokës bujqësore të kulluar, përmirësuar cilësinë e tokës e për rrjedhojë rritjen e përmirësimin e cilësisë së produktit lokal. Sistemi ujitës është një tjetër shërbim i ofruar për të cilin do të punohet për të rritur sipërfaqen e mbuluar përmes krijimit të skemave të ujitjes dhe modernizimit të tyre. Menaxhimi i qëndrueshëm dhe angazhimi i fermerëve është një detyrë e përbashkët për të pasur një rrjet ujitjeje eficient të shtrirë në të gjitha tokat tona bujqësore duke ndikuar direkt në mbarëvajtjen e prodhimit të produktit lokal. Bashkia Shkodër do të vendosë në dispozicion të fermerëve një strukturë të posaçme për informimin dhe asistencën në aplikimet në kuadër të fondeve kombëtare e IPARD, në zhvillim të sektorit.



Zhvillimi i Agroturizmit

Agroturizmi është një nga elementët kryesorë të zhvillimit rural. Me evolucionin e turistëve dhe diversifikimin e lartë që ka tashmë përsa i përket eksperiencës turistike, territori i Shkodrës duhet të ketë një ofertë të zhvilluar të agroturizmave. Gjithnjë e më tepër turistë zgjedhin të njohin lokalitetet e vendit tonë duke përdorur strukturat agroturistike. Ky sektor jo vetëm tërheq turistë por krijon edhe mundësi të mëdha për ekonominë rurale dhe angazhimin në punë të rinjve. Me veçoritë që paraqesin njësitë administrative të Shkodrës mbështetja e zhvillimit të agroturizmave, bujtinave dhe strukturave të vogla pritëse, do të jetë një pikë e fortë e mandatit tonë. Suporti i bashkisë përmes angazhimit të resurseve financiare dhe asistencës teknike për krijimin e këtyre strukturave ka në fokus banorët dhe kryesisht të rinjtë të cilët do të gjejnë mundësinë e zhvillimit të një biznesi kaq tërheqës ku puna me turistë dhe vizitor sjell përfitime ekonomike dhe gjeneron zhvillim edhe për të gjithë zonën duke e bërë më atraktive. Kombinimi i produktit lokal të veçantë me kulinarinë 'slow food' artizanatin dhe ofertën turistike natyrore e historike do të diversifikojë mundësitë e zhvillimit rural duke dhënë një prespektivë të re zhvillimore për banorët.




Promovimi i Produktit Lokal

Bujqësia, blegtoaria apo pylltaria janë sektorët kyç për përdorimin e tokës dhe menaxhimin e resurseve natyrore në zonat tona rurale. Falë sipërfaqeve të mëdha të kultivueshme dhe kushteve të mira klimatike ky sektor ofron mundësi të mëdha në krijimin e zinxhirit të vlerave dhe tërheqjen e investimeve duke marrë parasysh produktet me cilësi të lartë. Zhvillimi i produktit lokal dhe promovimi i produkteve specifike duke filluar nga produktet e bulmetit, zrazave, frutave, vajit të ullirit, mjaltit shpërndahet në të gjithë territorin sipas specifikave që paraqet secila zonë. Për prodhuesit dhe fermerët tanë është e nevojshme fillimi i politikave të bashkimit në Shoqëri Bujqësore, për të qënë më konkurrues në treg, duke rritur kështu kapacitetet e tyre prodhuese dhe cilësore. Organizimi i panairëve për promovim të këtyre produkteve si dhe asistencën ndaj fermerëve për lidhjen e kontratave të tregtimit do të jetë element kryesor në zhvillimin e ekonomisë rurale.





ORIENTIMI STRATEGJIK SHKODRA ME SHUMË QENDRA (POLICENTRIKE)




Plani Operativ i Rikualifikimit Urban

Rikualifikimi urban do të fokusohet në investimet që ndikojnë direkt në projektimin Shkodrës së Gjelbërt, Smart e të Jetueshme me lagje që ofrojnë shërbime publike që konsumojnë pak energji dhe janë të aksesueshme nga të gjithë. Rikualifikimi urban i qytetit do të jetë orientimi parësor për mandatin 2023 -2027 me fokus akset kryesore të qytetit si dhe rrugët e brëndshme të lagjeve dhe njësive administrative. Blloqet e pallateve do të marrin një vemendje të shtuar duke kryer investime në eficiencën energjitike të objekteve si dhe në krijimin e hapsirave shplodhëse e rekreative. Sipas prioritetit të dhënë çdo rrugë e qytetit do të përfshihet në planin operativ të rikualifikimit urban. Gjithashtu në çdo njësi administrative do të vijohet puna për sa i përket rikualifikimit të rrugëve të brendshme dhe shesheve të fshatrave duke u orientuar në zhvillimin e barabartë të të gjithë territorit. Me mirëadministrimin e fondeve tona dhe me tërheqjen e çdo donatori dhe partneri do të arrijmë që brenda këtij mandati të kemi investime të rëndësishme në akset rrugore të të gjithë territorit duke ndërhyrë në infrastrukturën rrugore por edhe në shërbimet publike për të rritur cilësinë e jetesës së banorëve.



Rregullimi i Portave Hyrëse të Qytetit

Shkodra është porta e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian përmes pikave kufitare të Hanit të Hotit dhe Muriqanit dhe së shpejti Zogaj. Akset kryesore Bërdicë – Xhabije, Muriqan – Shkodër, Shkodër – Hani i Hotit, Zogaj - Shkodër do të jenë akset kryesore të prezantimit të të huajve me qytetin duke marrë një vëmendje të shtuar sa i përket infrastrukturës, fasadave peisazhit dhe shërbimeve publike. Me projektet në zbatim nga Bashkimi Evropian Shkodra do të jetë qyteti ndales i Autostradës Adriatiko Joniane dhe Hekurudhes Vorë Hani i Hotit dhe impakti që çdo vizitor do të marrë do të jetë ai i një qyteti Evropian, me infrastrukturë dhe shërbime sipas standarteve. Rreth rrotullimet hyrëse e dalëse të qytetit do të jenë përfaqësuese të historisë dhe identitetit të Shkodrës. Do të përpiqemi të nxisim çdo partner e institucion përgjegjës për realizimin e bypassit lindor të qytetit të Shkodrës. Rregullimi estetik i portave hyrëse të Bashkisë Shkodër me anë të rikualifikimit të rrugëve, ndriçimit publik, dhe gjelbërimit do të përmirësojë imazhin dhe rrisë atraktivitetin e qytetit.



Qëndrat e Gravitetit të Fshatrave

Njësitë Administrative do të rikonceptohen me qëndra fshatrat të zhvilluara, të cilat do të krijojnë qendrën e gravitetit për të gjithë njësinë. Zhvillimi i tyre do të ndjekë orientimin e strategjisë së zhvillimit duke u organizuar në nyje bujqësore me një infrastrukturë të zhvilluar dhe me shërbime sipas standardeve. Rrugët e brëndshme, qëndrat e fshatit të rikualifikuara dhe me hapsira rekreative do të krijojnë mundësinë e Shkodrës Policentrike, ku zhvillimi urban hapet në çdo skaj të territorit, sipas specifikës së zonës. Fshatrat e Shkodrës kanë potenciale zhvillimore specifike që nga zhvillimi i sektorit të bujqësisë tek turizmi dhe politikat e bashkisë do të jenë të përqëndruara në specializimin e këtyre zonave sipas potencialeve që këto zona kanë. Qëndrat e grumbullimit, njësitë shëndetsore, tregjet e produkteve, ambjentet sportive dhe ato rekreative do të ndikojnë në rritjen e atraksionit dhe shërbimeve për zonat rurale.



Arredimi Urban

Shkodra do të ketë identitetin e saj përsa i përket arredimit urban sipas një qasjeje unike ku çdo investim do të integrojë të kaluarën me të tashmen e të ardhmen. Sistemi i ndriçimit, hapsirat shplohëse, trotualet, sheshet publike dhe fasadat e qytetit do të përcjellin tek banorët identitetin e Shkodrës me përdorimin e materialeve miqësore ndaj mjedisit, arkitekturës ekzistuese, materialeve inovative dhe teknologjisë Smart. Arredimi urban do të lidhet me përmirësimin e cilësisë së hapsirave të përbashkëta duke ndikuar në aspektin vizual të lagjeve dhe rrugëve jo vetëm në qytet por edhe në njësitë administrative. Rritja e hapsirave shplohëse, rikualifikimi i blloqeve të pallateve me eficiencë energjie, parkimet e makinave dhe bicikletave dhe zgjerimi i sipërfaqes së ndriçuar do të krijojë një mjedis të këndshëm duke valorizuar të gjitha aspektet e infrastrukturës arreduese të Bashkisë. Hartimi i një rregulloreje për arredimin urban, fasadat dhe tabelat do të jetë një dokument i cili do të orientojë të gjithë rigjenerimin urban të Shkodrës. Zonat me flukse të larta turistësh do të kenë një vemëndje të veçantë për të përcjellur tek vizitorët identitetin e Shkodrës me shërbime dhe infrastrukturë të zhvilluar duke përmirësuar edhe cilësinë e jetesës për banorët.




Shkodra në vitet e fundit ka pasur ndryshime demografike të mëdha, duke u rritur dhe zhvilluar nga ana urbanistike si qytet. Në këtë zhvillim janë krijuar zona të reja urbane të cilat kanë akoma nevojë për investime infrastrukture dhe rritje të shërbimeve për t'i integruar plotësisht me qytetin dhe urbanistikën e tij. Zona e ish – fermentimit, lagjja Mark Lula, zona e livadheve apo të tjera lagje të reja, të pas viteve 90 do të kenë një vëmendje të shtuar në vizionin e zhvillimit të bashkisë Shkodër. Nj. A. Rrethina si një nga ish-komunat më të mëdha në vend do të ketë ndërhyrje specifike në rikualifikimet urbane në përmirësim të jetesës së banorëve. Ky program do të përfshijë ndërtimet e rrjeteve KUB, KUZ dhe infrastrukturën e sinjalistikën për këto zona të reja zhvillimore. Integrimi i zonave informale përreth Shkodrës nuk do të ketë të bëjë vetëm me infrastrukturën por edhe me shërbimet social ekonomike duke zgjeruar kështu qendrën e qytetit e duke dhënë mundësi të reja për zhvillim urban. Bashkia Shkodër do të jetë një zë i fortë sa i përket komunikimit me kadastrën për çertifikimin e këtyre pronave ku tashmë qytetarët dhe bizneset kanë zhvilluar pronën e tyre.



Një nga karakteristikat e qytetit të Shkodrës është pedonalja e qytetit. Zona nga 28 Nëntori – Kolë Idromeno është tashmë qendra e gravitetit të qytetit me një numër të lartë biznesesh dhe frekuentuesish, duke u zhvilluar në një zonë shumë atraktive për çdo vizitor. Për të bërë sa më atraktive dhe krijuar lehtësi në lëvizshmërinë e kalimtarëve do të investohet në rikualifikimin e sheshit “Nënë Tereza” që lidh këto dy pedonale. Një tjetër ndërhyrje që do të rrisë atraksionin në zonë do të jetë rikualifikimi i rrugës “At Gjergj Fishta” duke plotësuar kështu të gjithë rrjetin e pedonales në qendër të qytetit. Gjithashtu pedonalja pranë muzeut Oso Kuka është një tjetër zonë tregtare dhe karakteristike ku vëmendja e bashkisë do të jetë maksimale për të mirëmbajtur dhe zhvilluar më tej shërbimet publike, që e bëjnë edhe me atraktive. Rritja e cilësisë së shërbimeve në këtë zonë do të jetë prioritet i Bashkisë për të nxitur edhe më shumë vizitueshmërinë dhe frekuentimin e bizneseve apo muzeve të zonës.

Zonat Pedonale



Rikualifikimi i bulevardeve të qytetit



Ky objektiv operacional synon rikualifikimin e fasadave, rikonceptimin e aksesit dhe lëvizshmërisë urbane si dhe rritjen e shërbimeve ndaj bizneseve të zonës duke dhënë një impakt pozitiv në zhvillimin e identitetit urban të Bulevardit Zogu I, Rrugës Europa, Bulevardit Bujar Bishanaku dhe Bulevardit Skënderbej. Zbatimi i këtij projekti synon transformimin e këtyre bulevardeve nga rrugë tranzitore hyrëse e dalëse të qytetit, në zona tërheqëse dhe të aksesueshme nga të gjithë, të cilat lidhin qytetin me resurset natyrore e turistike të afërta.

Rikualifikimi i fasadave dhe rritja e efijencës energjitike

Studimi dhe rikonceptimi i mobilitetit


Rikualifikimi i sipërfaqes së rrugës dhe infrastrukturës

Rikualifikimi i katit përdhe dhe ofrimi i shërbimeve ndaj biznesit Sheshet dhe hapsirat e gjelbërta





ORIENTIMI STRATEGJIK SHËRBIMET PUBLIKE PËR KOMUNITETIN




Përmirësimi dhe modernizimi i infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale duke mundësuar akses të plotë në sistemin e infrastrukturës rrugore kombëtare dhe ndërkombëtare, do të jetë një proces i vazhdueshëm duke ndërhyrë në çdo rajon e njësi administrative. Mirëmbajtja dhe rikualifikimi i rrugëve, trotuareve dhe shesheve publike është një prioritet i cili zgjat në kohë qëndrueshmërinë e investimeve dhe aksesin e përdoruesve të makinave, biçikletave apo këmbësorëve sipas standardeve. Mirëmbajtja e rrugëve rurale dhe akseve të rëndësishme të zonave malore mbetet një objektivi i rëndësishëm që do të përmirësojë lëvizshmërinë e banorëve në të gjithë territorin.

Siguria Urbane dhe Sinjalistika Rrugore janë shërbime të bashkisë për komunitetin të cilat do të zhvillohen sipas Planit të Mobilitetit, ku përcaktohen zonat e nevojshme për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale. Vëmendja do të jetë e shtuar sa i përket sinjalistikës pranë shkollave dhe rrugëve me fluks të lartë lëvizshmërie duke plotësuar edhe sinjalistikën orientuese turistike në shërbim të vizitorëve. Përdorimi i elementeve në ndihmë të personave me aftësi ndryshe do të lehtësojë lëvizshmërinë dhe do të ndikojë në përmirësimin e mobilitetit. Përmirësimi i sinjalistikës do të fokusohet tek vijëzimi i rrugëve kryesore të qytetit, vijëzimi i parkingjeve, parkingjet për persona me aftësi ndryshe, korsitë e biçikletave dhe vijëzime të këmbësorëve në degëzimet kryesore duke rritur sigurinë urbane, por edhe përmirësuar aspektin vizual të rrugëve.



Ndriçimi
SMART


Eficienca energjitime në ndriçimin publik do të jetë një nga projektet kryesore. Përmirësimi i menaxhimit bashkiak të energjisë do të zvogëlojë konsumin e energjisë, do promovojë burimet e energjisë së rinovueshme duke promovuar përdorimin e teknologjive energjitike inovatore dhe miqësore me mjedisin. Kjo ndërhyrje e ndarë në faza parashikon zevëndësimin e mbi 600 ndriçuesve në të gjithë qytetin me ndriçues LED duke ulur ndjeshëm kostot e energjisë publike si dhe rritur cilësinë e këtij shërbimi. Rruga pedonale “Gjuhadol”, Bulevardi “Zogu i Pare”, Rruga “Studenti”, Rruga “Wilson”, Bulevardi “Mehmet Pashë Plaku”, Rr. “Marin Bicikemi”, Rr. “Edith Durham”, Bulevardi “Skenderbeu”, Bulevardi “Bujar Bishanaku”, Rruga “Daut Boriçi”, Rruga “Kolë Heqimi”, Rruga “Mbreti Gent”, Rruga “Agron” janë rrugët dhe bulevardet kryesore të Shkodrës për të cilat do të zevëndësohet i gjithë sistemi i ndriçimit. Njëkohësisht do të vijohet puna për ndriçimin publik në njësi administrative, specifikiisht në çdo qendër fshati, duke rritur kështu sigurinë dhe sipërfaqet e ndriçuara në NJ.A.



7 km ndriçim publik me eficence energjie
100,000 m² sipërfaqe e ndriçuar

Rrjeti Ujshjellës Kanalizime

Sigurimi i ujit të pijshëm për banorët dhe bizneset është një detyrim i yni dhe do ja dalim që së bashku të arrijmë të kemi një rrjet mirë funksional të shpërndarjes brenda qytetit dhe në njësitë administrative. Mirë funksionimi i sistemit të kanalizimeve dhe trajtimi i ujrave të zeza do të jetë prioritet dhe ky sistem do të përmirësohet përmes bashkëpunimit që kemi me KfW për ndërtimin e impiantit të pastrimit të ujrave si dhe ndërtimit të rrjetit të ujsjellësit në zonat informale të Shkodrës dhe njësisë Administrative Rrethina. Shtrirja e rrjetit të kanalizimeve dhe ujsjellësit do të jetë e vazhdueshme duke mbuluar të gjithë territorin e Shkodrës si dhe të njësisve administrative sipas nevojave dhe standardeve. Furnizimi me ujë të pijshëm do të vijojë të ketë përmirësime dhe çdo investim rrugor që do të zhvillohet këto vite do të jetë i shoqëruar me të gjithë infrastrukturën nën tokësore të rrjetit të ujesjellësit. Eliminimi i humbjeve në rrjet do të ulë kostot dhe do të sigurojë një shërbim të përmirësuar për banorët. Rrjetet e reja do të shtrihen në zonën e Golemit, lagjen Mark Lulaj, zonën e ish fermentimit dhe në lagjen Kiras duke arritur që të kemi një mbulim të plotë të të gjithë territorit të qytetit. Rikonstruksione të rrjetit ujesjellës do të shtrihen në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i vjetër, Vinotekë, Fshat i Ri, Hot i Ri e Grudë duke përmirësuar ndjeshëm shërbimin në territor. Vëmendje të shtuar do të kemi në zonat turistike duke ofruar një shërbim cilësor në ndihmë të operatorëve të sektorit dhe turistëve.



Policia Bashkiake dhe Komuniteti


Policia Bashkiake është prezenca e jonë në territor dhe siguron administrimin e çështjeve dhe shërbimeve policore në kompetencë të saj. Ruajtja e rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, zbatimi i akteve të kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, zbatimi i rregullave të shfrytëzimit të hapësirave publike, mbështetja e strukturave të bashkisë në realizimin e aktivitetit të tyre, asistenca në rastet e emergjencave civile, mbikqyrja e objekteve dhe transportit në pikat kyçe të qytetit dhe garantimi i lëvizshmërisë së sigurtë apo bashkëpunimi me policinë e shtetit për garantimin e sigurisë publike të komunitetit, janë disa nga kompetencat e policisë Bashkiake. Me shtimin e kompetencave të këtij sektori është e nevojshme edhe rritja e numrit të punonjësve për të pasur një mbulim të plotë të territorit sa i përket këtyre kompetencave. Është e nevojshme të rritet bashkëpunimi me drejtorinë e Policisë për të pasur një shërbim më cilësor ndaj komunitetit në përgjigje të problematikave të ndryshme. Rritja e imazhit të kësaj strukture do të jetë detyrë e jona. Me institucionalizimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike është institucionalizuar edhe procesi i ndërveprimit mes institucionit të bashkisë dhe institucioneve ligjzbatuese.

Monitorimi Inteligjent i Qytetit



Në kuadër të rritjes së sigurisë publike dhe përmirësimit të bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese do të vijojë vendosja e kamerave të sigurisë për ambientet publike. Kjo bën që të kemi një qasje të re për sigurinë publike, mirëmbajtja dhe qendrueshmëria e sistemit të vëzhgimit me kamera (CCTV) dhe rritja e numrit të tyre me qëllim mbikqyrjen e ambienteve publike, në të cilin mund të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike, tregtare, sportive, kulturore, mjedise publike e private për shërbime, parkim automjetesh, ka qëllim rritjen e sigurisë publike. Rritja e sigurisë dhe qetësisë publike, sigurimin e monitorimit dhe kontrollit më të mirë të territorit duke investuar në blerjen dhe instalimin e rreth 30 kamerave me rezolucion të lartë ka qëllim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit të sigurisë dhe qetësisë publike në interes të komunitetit.




ORIENTIMI STRATEGJIK EKO MOBILITETI





Shkodra është qyteti kryesor i Veriut të Shqipërisë dhe si i tillë do të ketë një terminal qëndror të transportit ndërqytetas, i cili do të ofrojë kushtet dhe shërbimet e duhura për të gjithë udhëtarët. Përmes kësaj ndërhyrjeje do të lehtësohet trafiku brenda qytetit nga autobuzët dhe furgonat e linjave të ndryshme duke e përqëndruar këtë shërbim në zonën e caktuar. Terminali Multimodal Shkodër do të ofrojë një strukturë të mirë – organizuar për transportin ndërqytetas dhe do të jetë lehtësisht i aksesueshëm, i lidhur me infrastrukturën dhe efikas në ofrimin e shërbimeve për udhëtarët.



Duke marrë parasysh fluksin e turistëve dhe vizitorëve gjatë stinës së verës do të planifikohet ndërtimi i Terminalit Sezonal Velipojë. Përmes këtij projekti do të sistemohet dhe përqëndrohet transporti për dhe nga Velipoja në terminalin e qytetit Shkodër duke ofruar një shërbim sipas standardeve për turistët e shumtë dhe banorët e zonës. Terminali sezonal do të ofrojë informacion të qartë për udhëtarët, reduktim të trafikut, thjeshtësim dhe formalizim të transportit.




Stacioni i Trenit – është një tjetër terminal që do të rikualifikohet përmes fondeve të BE duke rikthyer në funksion lëvizshmërinë me trena. Linja hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, investim i cili do të lidhë rrjetin hekurudhor Shqiptar me atë Evropian do të ofrojë një tjetër modalitet transporti për udhëtarët. Ky investim përveç rikualifikimit të linjës hekurudhore do të ndërhyjë edhe në stacionin e trenit Shkodër duke e transformuar atë në një strukturë moderne.



Rrjeti i B biçikletave

Shkodra është qyteti i 12 në Evropë për përdorimin e biçikletave. Për të valorizuar këtë formë të mobilitetit dhe për të krijuar kushte të përshtatshme për qarkullimin e biçikletave duhet të përmirësohet infrastruktura e dedikuar për këtë transport ekologjik por edhe karakteristik të Shkodrës. Rrjeti i rrugëve pedales do të jetë i shtrirë në të gjithë qytetin duke filluar nga unaza e jashtme e qytetit në rrugët e brëndshme të tij. Ky rrjet pedales do të jetë i integruar me rrugët kryesore përmes përdorimit të ndarësve të gomës dhe monitorimit të vazhdueshëm të mbajtjes së lirë të këtyre korsive. Krijimi i vëndparkimeve për bicikleta në zonat me dëndësi të madhe të popullsisë do të jetë një tjetër shërbim që do t'i ofrohet qytetarëve për të nxitur kështu përdorimin e këtij mjeti alternativ të transportit.




Transporti Publik

Gjatë këtij mandati do të kemi mundësinë e nxitjes së përdorimit të transportit publik duke përmirësuar kushtet e këtij shërbimi dhe shtuar numrin e linjave brenda qytetit. Do të kërkohet bashkëpunimi me kompanitë private për fillimin e linjës së transportit publik të Unazës Shkodër. Përmirësim të vazhdueshëm do të ketë në ofrimin e shërbimit duke rritur edhe frekuencën, në mënyrë që të rritet numri i përdoruesve të transportit publik për të ndikuar në një qytet më të pastërt e më me pak trafik. Kategoritë nxënës, studentë e të moshuar do të kenë kosto preferenciale për përdorimin e transportit publik. Korsitë e mjeteve të transportit publik do të jenë të ndara dhe me sinjalistikën e duhur duke lehtësuar qarkullimin e mjeteve. Linjat e transportit publik do të jenë të lidhura me терминаlet si dhe do ndërtohen stacionet e reja të transportit urban shoqëruar me sinjalistikën dhe tabelat informuese. Bashkëpunimi me kompanitë private të cilat ofrojnë shërbimin e transportit midis qytetit dhe Nj.A. do të përmirësohet duke nxitur krijimin e linjave të reja. Një tjetër objektivi është ai i krijimit të linjës Muriqan – Shkodër.





ORIENTIMI STRATEGJIK SHKODRA E GJELBËRT



Rikualifikim i Parkut të Bexhistenit


Bashkia Shkodër ka qënë iniciatore e rikualifikimit të parkut të Bexhistenit që në vitin 2020, duke realizuar projektin e rikualifikimit të kësaj lulishteje, i cili do të financohej nga FSHZH. Pasi u shpall në tender për zbatim, projekti u anulua nga FSHZH për të realizuar një masterplan ndërhyrjesh, i cili përfshin edhe Kalanë dhe bypassin.

Hyrja e qytetit të Shkodrës, me trashëgiminë historike e natyrore që e karakterizon si dhe me rëndësinë që ka si portë hyrëse, së shpejti do të ketë një koncept të ri zhvillimi, i cili do të marrë formë nga rikualifikimi i Parkut të Bexhistenit. Parku i Bexhistenit do të jetë nyja ndërlidhëse e të gjithë trashëgimisë historike e natyrore të qytetit me kalanë "Rozafa", Liqenin e Shkodrës dhe lumin Buna, duke ofruar një atraksion të veçantë për të gjithë banorët, bizneset dhe turistët. Rikualifikimi i lulishtes do të krijojë hapsira të gjelbërta, sportive dhe shplohëse për frekuentuesit duke u transformuar në një nga zonat më të frekuentuara. Pranë urës së Bunës do të realizohet Moloja e varkave turistike përmes të cilave vizitorët e turistët do të kenë mundësinë të lundrojnë në liqenin e Shkodrës duke u lidhur edhe me molon e Shirokës, Zogaj dhe Vir – Pazarit, për të shijuar Liqenin e Shkodrës.



Kurora e Gjelbërt e Qytetit

Qyteti i Shkodrës është i rrethuar nga kodra dhe zona mjedisore me rëndësi të veçantë sa i përket gjelbërimit dhe kontributit në uljen e ndotjes mjedisore. Duke pasur të identifikuar zonën e Rrencit, Taraboshit, Brigjeve të lumit Buna dhe Maranajt do të ndërhyhet në rikualifikimin mjedisor të këtyre zonave duke shtuar gjelbërimin me mbjelljen e pemëve. Rritja e sipërfaqeve të pyllëzuara do të ndikojë direkt në rritjen e sipërfaqes së gjelbërt/banorë si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit duke parandaluar edhe riskun e erozionit. Krijimi i masivit pyjor rreth qytetit Shkodër do të përmirësojë ndjeshëm në ruajtjen e mjedisit, tokës, ujrave dhe ajrit duke dhënë impakt edhe në zhvillimin e ekonomive eko-mjedisore dhe turizmit natyror.




Shtimi, mirembajtja dhe nxitja e frekuentimit të hapësirave të gjelbërta

Ghkodra ka pasur në vite karakteristikë hapësirat e gjelbërta. Shtimi dhe përmirësimi i këtyre mjediseve do të vijojë duke rritur sipërfaqet e gjelbërta/banorë dhe krijuar mjedise gjithnjë e më atraktive. Sipërfaqja e gjelbërt në territorin e bashkisë do të rritet duke krijuar rrjetin e lulishteve duke filluar nga lulishtet brenda lagjeve tek gjelbërimi i qendrave të njësive administrative si dhe vëmendja e shtuar në zonat turistike. Përtej konceptit të shtimit të hapësirave të gjelbërta dhe mbrojtjes së zonave natyrore, investimet në territorin e bashkisë Shkodër do të jenë miqësore ndaj mjedisit duke pasur në vizion Shkodrën e Gjelbërt. Arredimi i hapësirave të gjelbërta do të jetë i ndarë në nivele sipas grupmoshave për ti bërë ato sa më atraktive për frekuentim nga të gjithë me kënde lojrash për fëmijët dhe zona të dedikuara për moshën e tretë. Këto mjedise do të jenë të plotësuara me tualetet publike, si dhe element në ndihmë të krijimit të shërbimeve të dedikuara për frekuentuesit e lulishteve.




Menaxhimi i Mbetjeve Urbane

Menaxhimi i mbetjeve është një nga funksionet që do të ketë vëmendje të shtuar duke filluar nga shtimi i frekuencave dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit në zonat urbane si dhe në zonat turistike. Do të promovohet fillimi i projekteve pilote për riciklimin e mbetjeve urbane si dhe ndarjen në burim për insitucionet dhe bizneset në mënyrë që të ulët sasia e mbetjeve të depozituara në landfill përmes vendosjes së koshave të ndarë dhe zhvillimit të fushatave sensibilizuese për nxitjen e riciklimin të mbetjeve. Grumbullimi derë më derë për zona të caktuara do të jetë një tjetër risi. Me identifikimin e vendndodhjes do të zbatohet projekti për ndërtimin e venddepozimit të mbetjeve inerte dhe qendra e stacionimit të mbetjeve urbane. Gjithashtu sa i përket kompostimit të mbetjeve organike do të identifikohen në njësi Administrative vendndodhjet për kompostmin e mbetjeve organike. Një risi që ka filluar të zbatohet dhe do të zhvillohet më tej është edhe monitorimi digjital i shërbimit të pastrimit që do të shërbejë për rritjen e cilësisë së shërbimit dhe nxitjen e ndërgjegjësimit të banorëve dhe bizneseve.





ORIENTIMI STRATEGJIK DJEP I KULTURËS, ARTIT DHE TRASHËGIMISË



Historia e artit dhe kulturës në Shkodër me institucionet e saj dhe trashëgiminë që ajo ruan në territorin e saj, e kanë bërë këtë qytet unik në llojin e vet. Në një vit mandat ne bëmë shumë, por kemi ende shumë ide dhe projekte për të çuar përpara. Me fondet e Bashkisë Shkodër dhe me mbështetjen e partnerve tonë dhe të bizneseve të qytetit, ne arritëm ta kthenim qytetin në vëmendjen e turistëve vendas dhe të huaj, përmes një kalendari të ngjeshur artistik dhe kulturor

përgjatë gjithë këtij viti, duke përfshirë të gjithë komunitetin art dashës të Shkodrës. Mbështetëm aktivitetet e traditës dhe krijimin e aktiviteteve të reja artistiko kulturore. Duke filluar nga Çmimi “Pjetër Gaci”, Koncertet e verës “Eja në Shkodër”, të zhvilluara në pedonale, mbështetëm rikthimin pas 15 vitesh të Inva Mulës në një koncert recital në Shkodër, festivalet “Za fest”, “Shkodra Jazz Festival”, “Ahengu Shkodran”, “Luleborë”, “Ndërmendje”, koncertet e fundvitit “Shkodra n’Fest” etj. tek aktivitetet e ndryshme artistike të Teatrit “Migjeni”, Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci”, Galerisë së Arteve, Bibliotekës “Marin Barleti”; mbështetëm dy festivale të filmit “Ekrani i Artit” dhe “Idromeno Film Festival”; mbështetëm formacionet artistike “Orkestrën Frymore” dhe Ansamblin.

Aktivitete, kemi arritur të kemi një shtrirje të aktiviteteve kulturore vjetore duke rikthyer energjinë dhe entuziazmin që përcjell kultura dhe arti në Shkodër.

Ja kemi dalë në një vit t’i rikthejmë qytetit një vlerë të munguar prej 32 vitesh, Orkestrën Simfonike. Përfunduam, me ndihmën e partnerëve tonë të biznesit, rikualifikimin e ambjentit të jashtëm të teatrit “Migjeni”, duke i kthyer godinës dinjitetin dhe madhësinë që ai tempull i artit mbart dhe duke bërë aty një ambjent rekreativ dhe artistik për qytetin.

Muzetë “Oso Kuka”, Vendi i Dëshmisë dhe Kujtesës, Muzeu i Kështjellës, janë çdo ditë e më shumë të frekuentuar nga vizitorët e huaj falë promovimit të jashtzakonshëm që i është bërë këtyre relikeve të qytetit.


Aktivitetet kulturore do të vijojnë të zhvillohen në të gjithë territorin duke nxitur turizmin kulturor, përmes paketave të dedikuara kulturore, përgjatë gjithë vitit. Gjithashtu kemi arritur të rikrijojmë marrëdhëniet institucionale me qytete historikisht të lidhura me kulturën e Shkodrës si Gjakova, Tetova apo Ulqini duke pasuruar dhe zgjeruar gamën e aktiviteteve edhe në rang kombëtar.

Të rinjtë dhe talentet e reja kanë patur aksesin e nevojshëm në aktivitetet artistike e kulturore duke marrë vendin që ju takon në trashëgiminë e vlerave kulturore të qytetit duke u përfshirë gjithnjë e më shumë në teatër, festivale dhe koncertet e zhvilluara. Shkodra e kulturës do të vijojë të jetë orientimi i punës tonë duke përcuar tek të gjithë identitetin kulturor që përfaqëson qyteti i jonë.





Infrastruktura e Objekteve Kulturere

Teatri “Migjeni” nuk është thjesht Nderi i Kombit, është krenaria jonë dhe misioni ynë është investimi për rikualifikimin e tij total, për t’i rikthyer jo vetëm një sallë dinjitoze me kushte europiane, por edhe duke nxitur dhe krijuar kalendare vjetore me aktivitete, me cilësi të lartë artistike. Do të ndërhyjmë në rikonstruksionin e sallës dhe instalimin e sistemit ngrohje-ftohje, duke ruajtur vlerat arkitektonike të trashëgimisë kulturore dhe akustike, si një nga sallat më të mira në rang kombëtar. Do të ndërhyjmë edhe në ambjentet e pushimit të artistëve dhe të përmirësimit të zyrave të administratës, duke krijuar kështu një ambjent komod dhe me standarte të larta për artistët tonë dhe miqtë kombëtar e ndërkombëtar, që herë mbas herë zgjedhin skenën e Teatrit “Migjeni” për të performuar. Gjithashtu do të punohet për realizmin e rikonstruksionit të Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Kujtim Alija”, Qendës Kulturore “Pjetër Gaci”, për të krijuar një mjedis komod dhe tërheqës për zhvillimin e mëtejshëm të talenteve të reja dhe realizimin e aktiviteteve artistike e kulturore.



SHKODRA, NJË MUZE I HAPUR

Trashëgimia kulturore e historike e Shkodrës është krenaria e jonë dhe për këtë mbështetja, promovimi dhe rivitalizimi i objekteve të trashëgimisë kulturore do të jetë i vazhdueshëm. Krijimi i hapësirave të reja të trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me institucionet kombëtare dhe donatorë, është një objektiv i punës tonë, për të realizuar një rrjet të ri muzeal që përfshin muzetë, shtëpitë muze dhe atraksione të reja që janë pjesë e mozaikut kulturor të Shkodrës. Do të punohet për ngritjen e Muzeut Etnografik, për rikonstruksionin e Banesës “Oso Kuka” dhe mirëmbajtjen e muzeut të “Dëshmisë dhe Kujtesës” si atraksione të veçanta të qytetit. Do të punohet për rivitalizimin e shtëpive karakteristike të Shkodrës duke i përfshirë në rrjetin muzeal. Shkodra e artit, me Operan e parë Shqiptare, me Orkestrën e parë frymore, Orkestrën e parë Simfonike dhe me trashëgiminë muzikore që ka, do të ketë Muzeun e Muzikës. Martirët e Shekullit “Via Crusis” është një tjetër ndërhyrje që do të realizohet në qytet për të krijuar një Memorial të Martirëve që dhanë jetën gjatë periudhës së komunizmit. Aksesimi i rrjetit muzeal për personat PAK dhe shtresat vulnerabël do të jetë falas për të nxitur vizitueshmërinë dhe përfshirë të gjithë në shijimin e trashëgimisë tonë kulturore.



Kultura Digitale

Shkodra si qendër e trashëgimisë kulturore jo vetëm Shqiptare por edhe e rajonit, do të ripërtërije dhe krijojë hapësira dhe ide të reja për të promovuar dhe përquar më tej trashëgiminë dhe kulturën që e karakterizon. Me zhvillimet e reja të teknologjisë, promovimit dhe informimit të turistëve, Bashkia Shkodër do të jetë e përfshirë në projektet që synojnë digjitalizimin dhe promocionin online të resurseve kulturore e artistike. Përmes angazhimit të të rinjve dhe kreativitetit të tyre do të arrijmë të realizojmë një platformë online e cila përmban të gjithë informacionin kulturor të muzeve dhe aktiviteteve tona kulturore duke arritur të komunikojmë me vizitorët përmes teknologjive të reja digjitale. Promovimi online i informacioneve dhe aktiviteteve kulturore do të bëjë që të arrijmë të tërheqim një numër sa më të lartë turistësh e vizitorësh që e zgjedhin Shkodrën jo vetëm për atraksionet natyrore e turistike por edhe për vlerat e larta kulturore e historike. Vendosja e QR code-ve, me informacionet në gjuhë të ndryshme do të jetë një vlerë e shtuar për çdo turist që vendos të vizitojë muzetë e Shkodrës.



Me punën, përkushtimin dhe vullnetin tonë, do të pasurojmë aktivitetet artistike e kulturore në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, duke nxitur turizmin kulturor përmes paketa turistike gjatë gjithë vitit. Do të thellojmë bashkëpunimin me organizatat artistike kulturore, të cilat janë një burim i çmuar idesh dhe projektesh të cilat e çojnë në një nivel ndërkombëtar emrin e qytetit tonë. Bashkia përmes mbështetjes financiare dhe teknike do të jetë një bashki e hapur dhe fleksibël për afrimin e të gjithë aktorëve që operojnë në fushën e artit dhe kulturës. Objektivi afatgjatë: Krijimi i “Shtëpisë së artit” për artistët interpretues, me standarte europiane, e cila do të përfshijë një skenë të re për publikun si dhe ambiente të reja provash për trupat tona artistike do të zhvillojë edhe më tej Shkodrën si Qytet i Memories dhe traditës qytetare. Do të vijojmë me mbështetjen e të rinjve me ide kreative për aktivitete kulturore; krijimin e hapësirave të reja rekreative për artistët amatorë dhe profesionistë. Mbështëtja e aktiviteteve të traditës dhe pasurimi me tendencat bashkëkohore në të gjitha fushat e artit duke thelluar bashkëpunimin dhe binjakëzimin me institucione të artit dhe kulturës rajonale e ndërkombëtare.

Shkodra Qyteti
i Memories
dhe traditës
qytetare



ORIENTIMI STRATEGJIK SHKODRA E SPORTIT

Shkodra është krenaria e sportit Shqiptar me një sërë figurash sportive të cilat kanë lënë shenjë, përmes rezultateve, në historinë e të gjitha disiplinave sportive. Që me strukturimin e «Shoqnisë Vllaznia» në 1919 Shkodra ka vijuar të jetë djepi i sportistëve duke u karakterizuar për angazhimin e të rinjve por edhe të të gjithë komunitetit në frekuentimin e aktivitetit sportiv. Duke filluar me futbollin, basketbollin, volejbollin, çiklizimin, notin, atletikën, boksën, peshëngritjen e të tjera disiplina, ekipet e Shkodrës kanë arritur të kenë rezultate maksimale historikisht, duke e ngulitur në memorien e të gjithëve, Shkodrën si qyteti i Sportit. Shkodra vijon të jetë qyteti me më shumë talente sportive të cilët tashmë konkurrojnë edhe në arenën kombëtare e ndërkombëtare. Programi i mandatit tonë të përbashkët ka synim përforsimin e këtij identiteti sportiv të qytetit përmes realizimit të aktiviteteve sportive/rinore me përfshirje masive të grupmohave me fokus kryesor të jetuarit shëndetshëm, socializimit por edhe rezultateve. Aktivitetet sportive do të shtrihen në të gjitha shkollat dhe komunitetet përgjatë gjithë vitit. Organizimet e aktiviteteve të mëdha dhe kampionateve të ndryshme sipas disiplinave janë një element promociional i historisë sportive të Shkodrës por edhe i promovimit të frekuentimit të këtyre disiplinave nga të rinjtë. Kështu do të organizohen: Maratona e pavarësisë, Ditët sportive, Beach volley, Street basket, Çiklizmi i rrugës dhe i malit, Beach Socker, Kupa e atletikës «Gëzim Mema & Vildan Tufi» si dhe mbështetja e çdo angazhimi qytetar për të organizuar aktivitete sportive, të cilat sigurojnë përhapjen masive të sportit në shoqërinë tonë. Realizimi i Muzeut «Vllaznia» është një tjetër objektivi i joni, për të krijuar një strukturë dinjitoze ku shfaqet para sportdashësve e gjithë historia e disiplinave sportive të klubit «Vllaznia»



Bashkia Shkodër në zbatim të legjislacionit në fuqi do të vijojë të jetë mbështetësja më e madhe e disiplinave sportive. Mbështetja 14 disiplinave sportive të sportit profesionist është ndër objektivat parësore duke pasur edhe rritje të vlerës financiare të akorduar. Bashkia ofron suport të vazhdueshëm për rritjen e kapaciteteve në menaxhimin e shoqatave sportive, për përmirësimin e performancës së tyre dhe arritjes së rezultateve sa më të mira. Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të zhvillimit të sporteve përmes ndërhyrjeve në infrastrukturë dhe mirëmbajtjes së objekteve sportive si Stadiumi «Loro Boriçi», Pallati i sportit «Qazim Dervishi», Fusha «Reshit Rusi», mjediset pranë stadiumit për zhvillimin e stërvitjeve ditore të ekipeve të ndryshme, do të shoqërohet me realizimin e hapësirave të reja sportive në bashkëpunim me FSHF, donatorëve dhe buxhetit të Bashkisë. Bashkia do të jetë institucioni promociional më i madh për masivizimin e frekuentimit të këtyre disiplinave duke orientuar të rinjtë drejt sportit profesionist. Akademia e futbollit, si një nga asetet më të rëndësishme të Shkodrës, do të vijojë të ketë mbështetjen maksimale. Mbështetjetë të dedikuara do të kemi edhe për ekipin e futbollit të femrave, që ja kanë dalë të na bëjnë krenar edhe në arenën ndërkombëtare.



Sporti në çdo Rajon e Njësi Administrative

Bashkia Shkodër me një shtrirje territoriale nga Thethi në Velipojë me 10 njësi administrative dhe 5 Rajone do të arrijë të sigurojë mundësinë që çdo banorë sidomos fëmijë dhe të rinj, të kenë sa më pranë hapsirat sportive e rekreative. Me qëllimin e rritjes së frekuentimit të sportit si një element që përmirëson cilësinë e jetesës është planifikuar që çdo rajon dhe lagje të ketë fusha sportive, të cilat mund të jenë në mjedise publike apo në mjediset e Shkollave, duke u aksesuar pa pagesë. Njësitë administrative sidomos fshatrat qendër njësie do të vitalizohen edhe përmes investimeve në fushat sportive duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë në aktivitete sportive. Shëndeti, mirëqënia dhe përfshirja sociale përqohen edhe përmes sportit. Hapsirat mes pallateve, pronat publike në rajone dhe njësi administrative ku ka flukse të mëdha banorësh do të rikualifikohen me objektivin parësor të krijimit të këtyre mjedisve sportive. Sapo kemi filluar dy projekte të tilla siç është ai i ndërtimit të fushës sportive në Postribe dhe pallati i sportit pranë shkollës Salo Halili dhe të tjera projekte të tilla do të shpërndahen në të gjithë territorin.




Jeto me Sportin

Projekti “Jeto me Sportin” synon rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve të komunitetit në sa më shumë aktivitete sportive duke zhvilluar më tej traditat sportdashëse të banorëve e duke përmirësuar kështu cilësinë e jetesës së tyre. Vizioni i Bashkisë Shkodër është transformimi i territorit në një hapësirë policentrike që ofron shërbime me të njëjtin standard për publikun në mënyrë të thjeshtë dhe të aksesueshme nga banorët dhe vizitorët. Nxënësit, Shoqatat e klubet e ndryshme sportive për të rinj por edhe komuniteti kanë nevojë të jenë të angazhuar në aktivitete sportive në terrene dhe ambiente të përshtatshme. Duke pasur një numër të madh nxënësish që frekuentojnë shkollat në Shkodër, ne duam të kontribuojmë jo vetëm në aktivitetet e edukimit dhe formimit por edhe për aktivitetet sportive, argëtuese e kreative duke i transformuar këto mjedise në qendra komunitare në shërbim të komunitetit. Jeto me Sportin do të krijojë mundësinë e shtrirjes së terreneve sportive në çdo rajon e njësi administrative duke i mundësuar çdo fëmijë e të riu aksesin dhe pjesëmarrjen aktive në aktivitetet sportive.





ORIENTIMI STRATEGJIK SHKOLLA CILËSORE NË SHËRBIM TË KOMUNITETIT DHE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN



Sistemi arsimor ka rëndësi të madhe në edukimin dhe zhvillimin ekonomik dhe social të qëndrueshëm të komunitetit tonë. Bashkia Shkodër ka një inventar prej 58 Shkollas 9-vjeçare e të mesme të cilat vit pas viti, me fondet e veta të bashkisë janë rikonstruktuar. Duke marrë parasysh shtrirjen territoriale dhe nevojën për të patur mjedise shkollore me infrastrukturë cilësore, ndërhyrjet infrastrukturore do të vijojnë duke barazuar cilësinë e mjediseve të shkollave si në qendër ashtu edhe në njësitë administrative. Shkolla duhet t'i mundësojë të gjithë fëmijëve që të kenë rezultate në mësim, të jenë të sigurtë, të shëndetshëm dhe aktivë në jetën komunitare. Përveç mirëmbajtjes së zakonshme që kryhet në infrastrukturën e shkollave në Shkodër do të fokusohemi në zbatimin e projekteve të rikualifikimit, të cilat përmirësojnë direkt kushtet dhe cilësinë e frekuentimit të shkollave nga nxënësit. Nga ndërhyrjet kryesore në infrastrukturë do të jenë: Rikonstruksionet e shkollave që kanë nevojë për ndërhyrje, rikualifikimi i mjediseve të jashtme të shkollave, rikualifikimi i shkollave në qytet dhe Nj. A dhe mirëmbajtja e vazhdueshme të mjediseve të brendshme të shkollave.




Bashkia Shkodër synon rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të komunitetit në sa më shumë aktivitete edukuese, sportive dhe kulturore duke zhvilluar më tej edukimin në shkolla përmes aktiviteteve rekreative, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetesës së tyre. Shkolla e hapur është një nyje e rëndësishme e shoqërisë sonë që fillon me integrimin e të gjithë komunitetit me ambientet shkollore, jo vetëm sa i përket mësimit por edhe për krijimin e mjediseve komunitare të shfrytëzueshme nga të gjithë. Krijimi i kushteve të përshtatshme për të mundësuar çdo nxënës dhe fëmijë që të ketë rezultate të kënaqshme në mësim, të jetë i sigurtë, i shëndetshëm dhe aktiv në jetën komunitare nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në edukim dhe në aktivitetet rekreative pas shkollore. Shkollat do të jenë të hapura për frekuentimin e nxënësve por edhe komunitetit gjatë pasditeve duke ofruar mjedise multifunkionale për secilin nga rajonet dhe Nj. A. duke afuar kështu të rinjtë tanë me aktivitetet sportive, artistike e kulturore dhe të zhvillimit të kapaciteteve jashtë shkollore.



Krijimi i kushteve për mbarëvajtjen e mësimimit

Eliminimi përfundimtar i ngrohjes me gaz do të vijojë, duke arritur deri në fund të mandatit zëvendësimin e sistemit të ngrohjes me gaz në të gjitha shkollat e Bashkisë Shkodër. Vendosija e impianteve të ngrohjes, rritja e efikasitetit energjetic si dhe përdorimi i paneleve diellore do të jenë projekte që do të shtrihen në të gjitha shkollat e territorit. Furnizimi i të gjitha shkollave me shërbimet mbështetëse, për mbarëvajtjen e mësimimit, do të jetë i vazhdueshëm duke plotësuar të gjitha shkollat me shërbimet dhe aksesoret e nevojshëm për mësimdhënie. Arredimi i brendshëm i klasave me banka dhe aksesoreve ndihmës për nxënësit dhe mësuesit do të krijojë kushtet e përshtatshme për zhvillim të nxënësve tanë sipas të gjitha standardeve. Shërbimi i pastrimit në shkollat e territorit tonë do të ketë një qasje të re përmes edukimit të brezave më ndarjen në burim të mbetjeve gjithashtu do të vijojnë projektet e rikualifikimeve me gjelbërim të mjediseve të jashtme. Sa i përket shërbimit të ruajtjes së Shkollave dhe monitorimit, Bashkia Shkodër do të ketë në vëmendje maksimale, rritjen e sigurisë së nxënësve dhe objekteve tona.



Kopshtet dhe Çerdhet

Bashkia Shkodër administron 55 kopshte dhe 6 çerdhe në të gjithë territorin e saj me një numër të konsiderueshëm fëmijësh që i frekuentojnë. Në mbështetje të këtij shërbimi do të vijojmë më shtimin e numrit të kopshteve dhe ambienteve të dedikuara për kopshtet dhe çerdhet si dhe rikualifikimin e ambienteve ekzistuese, për të krijuar kushte sa më të mira. Me mbështetjen dhe prioritetin që do t'i jepet këtij sektori do të kemi përmbushje të të gjitha nevojave të arsimit parashkollor përmes furnizimit të vazhdueshëm me kancelari, materiale pastrimi si dhe paisje e lojra rekreative për fëmijët. Eliminimi i ngrohjes me gaz do të jetë një prioritet absolut për këto ambiente në mënyrë që të rrisim sigurinë e frekuentimit të kopshteve tona, përmes vendosjes së kaldajave apo sistemeve alternative të ngrohjes. Do të vijojmë me rritjen e numrit të kopshteve që ofrojnë shërbimin e drekës duke përmirësuar këtë shërbim për prindërit që janë në punë. Investimet për efikasitet energjetic të ndërtesave dhe vendosja e paneleve diellore për kopshtet do të jetë një tjetër iniciativë që do të përmirësojë kushtet e frekuentimit duke ulur edhe kostot e dhënies së këtij shërbimi. Për herë të parë Bashkia Shkodër ka filluar pranimin në kopshtet publike të fëmijëve PAK, dhe do të kemi edhe shtim të numrit të edukatoreve me edukatore mbështetëse duke përjashtuar nga tarifat e frekuentimit të kopshtit këto fëmijë.



Bashkëpunimi mes Bashkisë dhe Universitetit mund të luaj një rol shumë të rëndësishëm në rikthimin e Shkodrës si qytet universitar, sidomos kur universiteti përballlet me numrin e ulët të studentëve. Bashkia mund të ndihmojë universitetin në rritjen e kërkesës për të ndjekur studimet në mënyra të ndryshme. Duke filluar nga promovimi i qytetit para studentëve potencial, ofrimi i mundësive për praktika profesionale pranë institucionit tonë, realizimi i projekteve të përbashkëta, angazhimi në simbiozë për ekspertiza profesionale dhe shkëmbime idesh, janë disa nga pikat që do të bashkëpunohet me Universitetin.

Zhvillimi i degëve të turizmit, financës, infermierisë, IT e të tjera degë që ndërlihen me funksionet e Bashkisë do të gjejnë mbështetje të plotë, që nga afrimi i studentëve për praktika pune, tek punësimi i tyre pranë institucionit të Bashkisë. Krijimi i kushteve sa më të mira të akomodimit për studentët me çmime të përballueshme. Karta studentit do të jetë angazhimi ynë për këtë mandat, për sigurimin e lehtësive financiare në transport apo shërbime të ofruara nga Bashkia dhe bizneset e Shkodrës.





ORIENTIMI STRATEGJIK SHKODRA E RINISË

Qendra Rinore
Atelie 'Hub' i
zhvillimit të
rinisë
Shkodrane

Qendra Rinore "Atelie" është qendra e parë publike në mbështetje të të rinjve, të cilët duan të zhvillojnë idetë dhe talentin e tyre në qytetin e Shkodrës. Kjo qendër është shërbim publik i Bashkisë Shkodër, e dedikuar rinisë si një hapësirë e sigurtë rinore, shumë-funksionale dhe mundëson marrjen e shërbimeve në: edukim formal dhe joformal, sipërmarrje, kulturë, informacion dhe teknologji. Përmes kësaj qendre Bashkia Shkodër do të vijojë fuqizimin dhe nxitjen e rinisë tone, jo vetëm për të dhënë

ide por edhe për të pasur një zë në vendimarrjen publike të Bashkisë. Duke parë tek rinia potencialin e jashtëzakonshëm në ide dhe energji, së shpejti do të krijohet Këshilli Rinor Vendor, përmes të cilit do të institucionalizohet përfshirja e të rinjve në vendimarrjen lokale. Qendra Rinore Atelie do të vijojë të jetë qendra e formimit, informimit dhe edukimit kreativ duke marrë mbështetjen nga ana e Bashkisë Shkodër për rritjen e partneriteteve me organizata dhe donator që kanë në fokus Rininë.




Krijimi i mundësive të trajnimit dhe formimit profesional është me shumë vlerë për të rinjtë e territorit të Bashkisë Shkodër, duke marrë parasysh që jemi një nga qytetet ku akoma ka një numër të madh të të rinjve. Me ndryshimet e këtyre viteve, të rinjtë kanë nevojë që të kenë një orientim dhe drejtim më të mirë drejt tregut të punës, duke i formuar dhe trajnuar në profesione që kanë treg pune të sigurtë. Përveç trajnimeve dhe mentorimit të zhvilluar, edhe mbështetja me grante për të rinjtë është një eksperiencë që do të vijojë, duke ndikuar direkt në zhvillimin e startup-ve dhe punësimin e të rinjve. Bashkia Shkodër ka qënë dhe vijon të jetë shumë bashkëpunuese me çdo partner dhe organizatë që ka në fokus rininë dhe zhvillimin e aftësive të tyre, në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimin, duke krijuar kushtet që të vijojnë të jetojnë në Shkodër dhe Shqipëri. Aktivitetet formuese do të përfshijnë jo vetëm formimin profesional por edhe atë kreativ dhe artistik duke identifikuar talente të reja.

Aftësimi
Profesional dhe
Kreativ





ORIENTIMI STRATEGJIK FAMILJET DHE MIRËQËNIA SOCIALE



Banesat Sociale dhe Strehimi

Një ndër funksionet e Bashkisë Shkodër është strehimi social. Bashkia Shkodër synon harmonizimin dhe bashkërendimin më efikas të shërbimeve sociale në mbështetje të grupeve sociale më në nevojë. Duke parë rritjen e nevojës për strehim social dhe banesave për familjet e reja Bashkia Shkodër do të rrisë numrin e banesave sociale, me kosto të pranueshme. Përmes përdorimit të instrumenteve zhvillimor me kushte dhe mbështetjes financiare për të garantuar strehim social, për shtresat vulnerabël të popullsisë, do të arrijmë të përmirësojmë cilësinë e jetesës së banorëve tanë. Hartimi i planit 5 vjeçar të strehimit social tashmë është drejt miratimit dhe do të jetë një dokument referencë për këtë sektor duke rritur vit pas viti numrin e banesave sociale dhe familjeve përfituese. Procesi i subvencionimit të qerasë dhe përfshirja e sa më shumë familjeve të reja në programet e përfitimit të kredive është një tjetër instrument financiar në shërbim të qytetarëve tonë, për blerjen e banesave, mbështetjen e familjeve vulnerabël për strehim dhe ndërtimin në pronat truall të bashkisë të objekteve për strehim. Godinat sociale dhe përmirësimi i kushteve të banimit të komunitetit Rom ka përfunduar duke akomoduar familjet përfituese. Ky proces do të vijojë për rritjen e kapaciteteve akomoduese. Banesat sociale me qira pranë ish konviktit të shkollës Veterinare janë një tregues i punës së realizuar dhe i potencialeve të tjera që kemi, për të garantuar këtë shërbim për komunitetin tonë. Bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe donatorët do të jetë i vazhdueshëm për rritjen e këtyre kapaciteteve në territorin e Bashkisë Shkodër.





Edukimi Qytetar

Edukimi qytetar është një proces i vazhdueshëm i realizuar nga Bashkia Shkodër për orientimin, këshillimin dhe ndërgjegjësimin për shërbimet, në kuadër të rritjes së vetëdijes së qytetarëve për përmirësimin e jetesës së shëndetshme dhe në harmoni me komunitetin. Kemi tashmë 12 qendra komunitare në territor, përmes të cilave ofrohet shërbimi i këshillimit, orientimit, mbrojtjes së fëmijëve, shërbimet për familjen, fuqizimi ekonomik e social, programe prindërimi e të tjera shërbime në funksion të zhvillimit social të komunitetit. Realizimi i aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere për komunitetin do të ndikojë në qytetarinë aktive me përfshirjen e specialistëve dhe ekspertëve tonë si dhe organizatave të ndryshme, të cilat mbulojnë tematikat sociale të territorit. Trajnime të vazhdueshme do të zhvillohen për mësuesit dhe edukatorët, të cilët janë përçuesit e edukimit të nxënësve. Shtresat vulnerabël dhe me problematika sociale do të vijnë në fokusin e shërbimit social për t'i aftësuar dhe krijuar mundësinë e qënies së barabartë si në informacione ashtu edhe në aksesin ndaj të drejtave të tyre.



Shkodra e Aksesueshme

Ndërtimi i qendrave multifunkionale duke u bazuar në rezultatet konkrete që kemi patur nga realizimi i investimeve të ngjashme, do të jetë një instrument përmes të cilit do të rrisim kapacitetet infrastrukturore për shpërndarjen e shërbimeve sociale dhe kujdesit shëndetësor parësor në territor. Përmirësimi i aksesueshmërisë në mjedise, rrugë e trotuare, planifikimi i hapësirave të parkimit të dedikuara për personat me aftësi ndryshe, përmirësimi i shërbimit të transportit, do të krijojmë kushte të barabarta aksesit për të gjitha shtresat vulnerabël të komunitetit. Vendosija e rampave në shkolla dhe institucionet tona publike do të krijojë mundësinë e të gjithëve për të marrë shërbimet e ofruara. Do të fillojmë implementimin e projekteve pilote për infrastrukturën dhe sinjalistikën e njerëzve që nuk shohin/dëgjojnë si dhe do të ofrojmë shërbim të dedikuar të këshillimit administrativ për të gjithë ato persona që kanë nevojë për asistencë. Objektet, rrugët dhe trotuaret në administrimin e Bashkisë do të kenë akses të plotë për personat PAK.



Institucionet Rezidenciale

Bashkia Shkodër ka në administrimin e saj edhe dy institucione rezidenciale si shtëpia e fëmijës 0-5 vjeç dhe shtëpia e fëmijës 6-15 vjeç, të cilat japin një shërbim human për fëmijët e braktisur, jetimët biologjik apo social. Mbështetja jonë për garantimin e infrastrukturës cilësore për këto dy mjedise kaq të rëndësishme për komunitetin tonë, do të jetë e vazhdueshme. Fëmijët në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç, përveç shërbimit rezidencial marrin edhe përkujdesje sa i përket formimit psikosocial, edukues, mjekësor dhe të integritetit në komunitet, përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme rekreative. Për këtë Bashkia Shkodër do të angazhohet në mbështetje të këtij institucioni për të fuqizuar familjet si dhe siguruar një mirëqënie të barabartë për të gjithë fëmijët e akomoduar. Bashkia Shkodër ka në pronësi të saj shtëpinë e fëmijëve në Velipojë dhe për të garantuar një infrastrukturë cilësore do të ndërhyjë në rikualifikimin e këtij objekti për të ofruar kushte të mira për fëmijët që akomodohen gjatë sezonit veror. Një tjetër projekt pilot që ka filluar të japë rezultatet e tij dhe që do të shtrihet edhe më gjërë është “Shtëpia Familje” përmes të cilës jepet shërbim i dedikuar dhe hidhen hapat e de-institucionalizimit të fëmijëve.

Qendra e Zhvillimit është një tjetër institucion i përkujdesit shoqëror, qëllimi i të cilit është përkujdesi dhe riaftësimi fizik dhe mendor i personave me aftësi ndryshe. Mirëmbajtja e institucionit dhe ofrimi i shërbimeve të dedikuara për trajtimin dhe integrimin e personave me aftësi ndryshe do të jetë prioritet për ne për të siguruar kushte sa më të mira rezidenciale.




Mirëqënia Sociale

Bashkia Shkodër së shpejti do të ketë Planin Social të përditësuar përmes të cilit do të identifikohen dhe fillojë zbatimi i programeve në mbështetje të mirëqënies sociale. Mbrojtja dhe kujdesi për fëmijët në situatë rruge do të marrë një tjetër qasje përmes bashkëpunimit edhe me institucionet kombëtare për të reduktuar në maksimum këto situata përmes rritjes së mbështetjes të familjeve dhe evidentimit e denoncimit të shfrytëzimit të të tilla rasteve. Njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe grave do të vijojë identifikimin e rasteve dhe zhvillojë aktivitete konkrete në mbështetje të familjeve që janë përballur me problematikën e dhunës në familje. Gjithëpërfshirja e fëmijëve më aftësi ndryshe në sistemin parashkollor është një tjetër politikë që do të zhvillohet për të përmirësuar cilësinë e jetesës të të gjithë banorëve tanë. Shërbimet ditore për të moshuarit dhe krijimi i sa më shumë hapsirave dhe faciliteteve për përditshmërinë e tyre është një objektiv i rëndësishëm për t'i kthyer këtij brezi kontributin që kanë dhënë në vite. Administrimi i shërbimeve sociale në territor është një prioritet i joni për të asistuar shtresat në nevojë, personat me aftësi ndryshe, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar në ligj. Ofrimi i asistencës në para dhe në natyrë, për të dhënë mbrojtje shoqërore për familjet, fëmijët dhe personat e papunë do të zbusë problematikat sociale të banorëve tonë.



Shërbimi Shëndetësor

Me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe cilësisë së jetesës së komunitetit përgjatë gjithë vitit, Bashkia Shkodër do të vijojë me aktivitetet informuese dhe edukuese të shëndetit parësor. Për të pasur ambiente moderne dhe sipas standardeve, një vëmendje e veçantë do t'i jepet rikonstruksionit dhe përmirësimit të kushteve të qendrave shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor në të gjithë territorin dhe mirëadministrimit të këtyre strukturave. Kemi të identifikuar të gjitha nevojat për ndërhyrje dhe do të procedohet me investimet për rikonstruksionet e këtyre objekteve për të dhënë një shërbim cilësor për banorët tonë. Investimet në ndërtimin e qendrave multifunkionale do të kenë të përfshirë edhe qendrat shëndetësore, duke u përqëndruar në godina të përbashkëta të gjitha shërbimet ndaj komunitetit. Jemi në proces të rikualifikimit të këtyre objekteve, duke filluar nga qendrat shëndetësore të qytetit tek ato të Njesive Administrative si dhe rëndësi për këtë objektiv do të kenë qendrat në zonat turistike, për të dhënë një shërbim sipas standardeve të kërkuara.





ORIENTIMI STRATEGJIK
SHKODRA DHE MARRËDHËNIET
RAJONALE E NDËRKOMBËTARE

Shkodra do të vijojë të jetë bashkëpunuese me insitucionet shtetërore, partnerët e huaj apo organizatat e ndryshme për të krijuar mundësi alternative investimesh, përveç fondeve tona. Bashkia Shkodër do të mbajë dhe fuqizojë lidhjen ndërmjet Bashkisë dhe Përfaqësive të huaja të akredituara në Shqipëri. Bashkëpunimi me donatorët e rëndësishëm si BE, Banka Botërore, GIZ, UNDP etj., do të jetë i vazhdueshëm ashtu siç kemi dhënë shembull këtë vit, duke pritur dhe krijuar linja bashkëpunimi me çdo ambasadë dhe agjenci zhvillimore në Shqipëri.

Shkodra dhe Partnerët e Huaj

Bashkia Shkodër si qendër administrative dhe institucioni më i rëndësishëm i rajonit të Veriut do të vijojë të jetë pjesë aktive e projekteve IPA Shqipëri – Mali i Zi dhe IPA Itali – Shqipëri – Mal i Zi, duke përfutur fonde të cilat shkojnë në shërbim të realizimit të objektivave tonë dhe duke e bërë Shkodrën kryeqëndër të këtyre bashkëpunimeve. Çdo ambasadë dhe agjenci zhvillimi e huaj gjen në Bashkinë Shkodër një partner të hapur dhe bashkëpunues për zhvillimin e projekteve, investimeve dhe punëve, në përmirësimin e cilësisë së jetesës të banorëve tonë. Tashmë kemi një sërë projektsh madhore të investimeve që po realizohen nga bashkëpunimi i shtuar me delegacionin e Bashkimit Europian siç janë, autostrada Adriatiko – Joniane, Rrjeti Hekurudhor Vorë – Shkodër – Hani i Hotit, projekti i Gazjellësit IAP, rruga Shirokë – Zogaj dhe rrjeti i kanalizimeve të zonës, molot e liqenit e të tjera investime që do të rikualifikojnë bregun e liqenit. Bashkëpunimi me KfW për realizimin e impiantit të pastrimit të ujrave të zeza dhe shtrirjes së rrjetit të kanalizimeve dhe ujsjellësit është një tjetër tregues që Shkodra është një partner i besueshëm dhe konkret që përgjigjet ndaj çdo thirrjeje për investime në shërbim të qytetarëve. Përveç realizimit të këtyre investimeve vijojmë të jemi bashkëpunues dhe të hapur për realizimin e aktiviteteve të ndryshme që përçojnë në territor qasjen e zhvillimit të partnerëve tonë të huaj. Bashkëpunimi me Ambasadat për tërheqjen e bizneseve të huaja të interesuara për të investuar në Shkodër do të jetë i vazhdueshëm duke u bërë promotori më i madh i Shkodrës dhe kapitalit njëjësor e territorial tek të gjithë të interesuarit.

4th Call for Proposals published!



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Funded by the European Union




Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor
Instrumenti Lehtësues i Projekteve të Infrastrukturës
Asistenca Teknike 6 (IPF6)
TA 2016032 RO IPA

Projekti paraprak i Gazjellësit Jonian-Adriatik
– Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë




Financial under specific grant agreement no. 2015048-253 from the EU IPA II Multi-Beneficiary Programme for Albania, Bosnia and Herzegovina, North Macedonia, Kosovo*, Montenegro and Serbia

Western Balkans Investment Facility Infrastructure Project Facility Technical Assistance 5 (IPF 5)
TA2015030 RO IPA

Feasibility Study for the Adriatic-Ionian Road Corridor (Route 1 and Route 2) Montenegro and Albania
WB14-REG-TRA-01




Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor
Instrumenti i Përgatitjes së Projekteve në Infrastrukturë
Asistenca Teknike 6 (IPF6)
TA 2016032 RO IPA

WB16-ALB-TRA-01
Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit Shqipëri






ORIENTIMI STRATEGJIK
BASHKI TRANSPARENTE DHE
PRANË QYTETARIT

E-Qeverisja

Bashkia Shkodër ka të strukturuar zyrat e shërbimit ndaj qytetarëve dhe të interesuarve për të marrë shërbime apo informacione në Bashki, përmes zyrave me një ndalesë Z1N. Çdo lagje dhe njësi administrative ka të strukturuar këtë sistem që ofron mbi 76 shërbime pa patur kontakt me administratën duke marrë përgjigje brenda afateve ligjore të përcaktuara. Ne do të punojmë për sa i përket hapjes së bashkisë ndaj banorëve tanë në mënyrë që të thjeshtohet edhe më tej marrja e shërbimeve në bashki, kjo duke përdorur inovacionin dhe teknologjitë e reja të tregut.

Bashkia Shkodër vlerëson rëndësinë e transparencës së administrimit të fondeve si instrumentin kryesor të mirëmenaxhimit dhe për këtë do të vijojmë të jemi leader në Bashkitë e Shqipërisë. Në të gjitha raportet e qeverisjes lokale Bashkia Shkodër është në vendin e parë për transparencën dhe qeverisjen me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe do të vijojmë të jemi të tillë. Transparenca dhe menaxhimi financiar, zbatimi e së drejtës për informim, konsultimin publik e llogaridhënien, angazhimin dhe premtimet e mbajtura, shpërndarja e barabartë e shërbimeve dhe investimet vendore në çdo fshat e në çdo lagje, përfaqësojnë instrumentet bazë të punës tonë dhe modelin e qeverisjes vendore.

Administrimi i
Rajoneve dhe
Njësi
Administrative


Administrimi i 5 Rajoneve të qytetit dhe 10 njësi administrative do të ketë përmirësime të ndjeshme, përmes rikualifikimit të godinave ku banorët marrin shërbimet e Bashkisë, pa patur nevojë që të vijnë në ambientet e Bashkisë Shkodër. Inspektorët e rajonit dhe punonjësit e njësi administrative janë përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve dhe shërbimeve në territor dhe përmes komunikimit në rrjet më drejtoritë përkatëse të bashkisë, do të adresohen problematikat e ndryshme si nevojat për ndërhyrje në infrastrukturë, pastrimi, gjelbërimi, sinjalistika apo çdo shërbim tjetër të ofruar nga Bashkia, duke e bërë më eficiente punën dhe garantuar zgjidhje të problematikave në kohë të shpejtë. Banorët dhe të interesuarit për shërbime bashkiake kanë mundësi që aplikimet e tyre t'i realizojnë pranë zyrave të rajoneve dhe njësi administrative duke arritur që të marrin edhe shërbime në kohë më të shpejtë dhe pa pasur nevojë që të vijnë në zyrat e Bashkisë. Gjatë mandatit tonë do të kemi mundësi që të shtojmë edhe shërbime të tjera për banorët dhe bizneset duke thjeshtësuar sa më shumë çdo procedurë administrative dhe burokratike të Bashkisë Shkodër.

Marrëdhëniet
me
Institucionet

Bashkia Shkodër është përfaqësuesi kryesor i banorëve, bizneseve dhe territorit me të gjitha institucionet dhe agjencitë qeveritare. Duke qenë qendër rajonale e administrimit dhe përfaqësues i zërit të qytetarëve, do të vijojmë të kemi marrëdhënie të strukturuar me drejtorinë rajonale të arsimit, operatorin e shpërndarjes së energjisë, bordit të kullimit, ARRSH, prefekturën, drejtorinë e transportit, drejtorinë rajonale të Tatimeve, si dhe secilën ministri të linjës për përmirësimin e shërbimeve në territor. Një rëndësi të veçantë do të ketë komunikimi me kadastrën për zgjidhjen përfundimtare të problematikave të pronësisë për të lejuar zhvillimin e pronës. Kemi akoma zona zhvillimore me potencial të jashtëzakonshëm si Thethi, Shirokë - Zogaj apo prona të njësi administrative, për të cilat banorët dhe bizneset nuk kanë çertifikimin e pronësisë, i cili është një element bazik për zhvillimin e territorit.





ORIENTIMI STRATEGJIK MBROJTJA CIVILE



Mbrojtja Civile me situatën që ka kaluar Shkodra këto vite është një tjetër tematikë me shumë rëndësi për administrimin e mirëqënies së banorëve tonë. Asistenca do të vijojë të jetë e vazhdueshme për përballimin e situatave të përmbytjeve dhe projekteve konkrete që minimizojnë këtë situatë do të zbatohen së shpejti, me rikualifikimin e të gjithë rrjetit të kanalizimeve të zonës së nën Shkodrës dhe mbi Shkodrës. Bashkia Shkodër vijon të jetë një zë përfaqësues i banorëve dhe fermerëve të dëmtuar

nga përmbytjet e shkaktuara nga Hidrocentralet, përmes kërkesave të vazhdueshme për dëmshpërblim. Zhvillimi i aktiviteteve në funksion të parandalimit të përmbytjeve është një proces i vazhdueshëm i Bashkisë Shkodër dhe përmes ndërhyrjeve në kanalet kulluese do të zbuten pasojat e përmbytjeve. Asistenca ndaj familjeve dhe fermerëve do të jetë e vazhdueshme nga ana e jonë për të siguruar strehim dhe lëndë ushqimore për bagëtitë, por objektivi kryesor do të jetë ai i mos përsëritjes së situatave të tilla me bashkërendimin e ndërhyrjeve me institucionet shtetërore.



Shërbimi zjarrfikës tashmë ka një flotë me automjete moderne për përballimin e emergjencave nga zjarri, falë bashkëpunimeve që kemi patur me shtete të ndryshme si Italia dhe Belgjika, të cilat na kanë asistuar me donacione të mjeteve zjarrfikëse, aparaturave dhe veshjeve të dedikuara. Rritja e kapaciteteve në mjete dhe paisje është një objektivi i rëndësishëm për të patur ndërhyrje efikase dhe mbrojtje të punonjësve tanë. Një projekt pilot që do të zhvillohet është ai i instalimit të hidrantëve në zonat ku aksesimi me mjete është i vështirë, duke garantuar një shërbim cilësor në rastet e nevojës. Bashkia Shkodër së shpejti do të fillojë rikonstruksionin e repartit zjarrfikës dhe ndërkohë puna e vazhdueshme për trajnimin e stafit, rritjen e kapaciteteve, mbrojtja civile, evakuimi dhe shpëtimi i personave në emergjencë civile do të jetë objektivi parësor, për garantimin e sigurisë së banorëve.

